



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 104/02-6030/26
Kaçanik, 30.03.2026

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 30 mars 2026, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL
PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 104/02-6030/26 - më tekstin e mëtejme: Plani Vjetor i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026, i hartuar nga KKSB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësynimet në lidhje me objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2026.
3. Plani i Punës së KKSB, është përmbledhur në gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2021- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës (përmes saj njoftohen anëtarët e KKSB), Arkivi.

